

**KUSHTE TE VEÇANTA DHE SPECIFIKIME TEKNIKE**

**PER BLERJE ME TENDER ME PROCEDURËS:**

**Blerje makina elektrike**

**I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

**1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

**2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:**

**2.1. Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**2.2 KAPACITETI EKONOMIK DHE FINANCIAR:**

**2.2.1** Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2020, 2021, 2022 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar nuk duhet të jetë më e vogël se 40% të fondit limit.

**2.2.2** Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020, 2021, dhe 2022 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

**3. KAPACITETI TEKNIK**

**3.1** Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më pak se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, kontraten midis paleve ku të shënohet preventivi dhe vlera dhe/ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

**3.2** Operatori ekonomik ofertues duhet të jete i pajisur dhe të paraqesë Certifikatat të pershtatshme ose ekuivalentet e tyre për objektin e prokurimit si me poshte:

Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO të sipercituar).

**3.3** Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori zyrtar për mallrat objekt prokurimi kjo e vërtetuar nepermjet dokumentave orgjinal si perfaqesues i kompanise prodhuese për mallin/mallrat zerat e listes:

Ne rast paraqitje Autorizimi Distributori, OE duhet të paraqesë ne leter angazhim ose Akt marreveshje midis prodhuesit dhe distributorit e vlefshme midis tyre, mbi të drejtat e furnizimit me llojin e mjetit të ofruar ne Republiken e Shqiperise.

Autorizimi duhet të përmbaje të dhena të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon/fax/e-mail/website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

**3.4** Operatori ekonomik duhet të paraqesë Certificatë konformiteti (të lëshuar nga prodhuesi) që vërteton të dhënat teknike, standartin e prodhimit sipas kërkesave mbi standartin të përcaktuar në specifikimet teknike dhe librezë shërbimi mirëmbajtje.

**3.5** Operatori ekonomik ofertues duhet të dëshmojë se ka në pronësi ose me kontratë, servis të specializuar për mirembajtjen dhe riparimin e mjeteve gjate periudhes se garancise.

- a) për ambjentet të cilat janë në pronësi, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin që vërteton pronësinë.
- b) Për ambjentet me qera, Operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e qerasë të shoqëruar me dokumentin që vërteton pronësinë e qeradhënësit me afat kohor deri në perfundimin e garancise.

**3.6** Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike, për të gjitha mallrat objekt prokurimi, në formën e një table sipas modelit të mëposhtëm, e cila duhet të plotësohet në mënyrë rigoroze. Oferta teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë;

-Emri i kompanisë prodhuese

-Emërtimi i Katalogut të prodhuesit ose i skedës teknike

-Numri i faqes në katalog ose në skedën teknike ku ndodhet artikulli

-Numri (kodi) identifikues i artikullit të ofruar, i shënuar me një shenjë dalluese.

Të dhënat e deklaruara në ofertën teknike duhet të korespondojnë me të dhënat për artikujt në katalogët/skedat teknike të dorëzuara.

Moskorespondimi i këtyre të dhënave do të sjellë pavlefshmëri të ofertës.

**3.7** Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit/ve për listën e mallrave objekt prokurimi, në të cilat të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen.

**Shenim:** Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i perkasin.

## **KUSHTET PER TU ZBATUAR NE PRANIM.**

**Në fazën e pranimit,** janë të detyruar të paraqesin;

1. **Dokumente origjinale** ose të njëvlefshme, të deklaruara në institucionet tona zyrtare, me anë të të cilave të demonstron, se origjina e prodhimit të materialeve të furnizuara është e njëjtë me atë të paraqitur në dokumentet e ofertimit.
2. Dokumenta që vërtetojnë Origjinën e Produkteve.
3. Kataloge ose skeda teknike ,teste që shoqerojnë mallin në fazën e dorzimit.
4. Test raporte
5. Makinat do të jenë me ngjyre Blu 2 cope dhe 1 (një) me ngjyre të Zezë, si dhe do të jenë me logon e AK.

### **Shenim:**

Në rast të mos paraqitjes dhe mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta në fazën e furnizimit do të konsiderohen si kushte për refuzim të pranimit të mallit.

## **VERIFIKIMI DOKUMENTEVE TE DOREZUARA**

**AUTORITETI KONTRAKTOR**, rezervon të drejtën të kryejë, të gjitha verifikimet që i konsideron të nevojshme, për tu garantuar mbi vlefshmerine e dokumenteve të kërkuara në **pikën, 3.5.** të shënuara më sipër.

## **GARANCIA E PRODUKTEVE TE FURNIZUARA**

Produktet e furnizuara, **duhet të jene te reja** si dhe të kenë një garanci përdorimi, **jo me pak se 7 vjet ose 150,000 km** per produktet nga marrja e tyre në dorëzim.

## **AFATI I LEVRIMIT**

Afati i lëvrimit kërkohet të jetë për një periudhë prej 1 muaj nga dita e lidhjes së kontratës.

OFERTA GJITHASHTU DUHET TË PAJTOHET NË MËNYRË STRIKTE ME TË GJITHA URDHËRAT DHE KËRKESAT E TJERA TE KËTIJ PROKURIMI TE SHENUARA NE DT.

## **KOMISIONI I PERCAKTIMIT TE SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE PERLLOGARITJES SE VLERES SE KONTRATES**